



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1184
Data e Vendimit: 18.12.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Nika PrO- Ing SH.P.K" kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti" me numër të prokurimit 206-25-80-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues AK Ministria e Shëndetësisë, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 12.12.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si jo e plotë, ankesa e OE "Nika PrO- Ing" SH.P.K me nr. të protokollit 2025/1184, e datës 01.12.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti" me numër të prokurimit 206-25-80-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues AK Ministria e Shëndetësisë, në cilësi të AK-së.

II. I lejohe, autoritetit kontraktues- Ministria e Shëndetësisë që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e "Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti" me numër të prokurimit 206-25-80-5-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 01.12.2025, ka pranuar ankesën me Nr. Protokollit 1184/2025 nga OE "Nika PrO- Ing SH.P.K" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti" me numër të prokurimit 206-25-80-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues AK Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 02.04.2025 Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për Kontratë.

Me datën 12.11.2025 AK ka publikuar raportin e rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit.

OE "Nika PrO- Ing SH.P.K" me 17.11.2025 ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 21.11.2025 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së për refuzim, Operatori Ekonomik "Nika PrO- Ing SH.P.K", me 01.12.2025, ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 2025/1184 (Nr. protokolli).

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

.Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi, zyra e pranimit në OSHP, konstatoi se operatori ekonomik ka parashtruar dy ankesa (1182/25 dhe 1184/25 dhe ka paguar vetëm një depozite dhe në këtë rast ankesa me nr. 184/25 si e tillë refuzohet.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: